# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5848
E enjte, 8 gusht 2019
çmimi 0.40 €


## Gjykata Penale e Shkupit: Tomor Morina nuk duhet të ekstradohet në Serbi

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BESNIK BISLIMI FAQE 4-5

# Bashkëpunimi me LDK-në mund të përfshinte dy mandate qeverisëse



Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi, beson në një koalicion parazgjedhor me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se një bashkëpunim i tillë do të mund të përfshinte dy mandate qeverisëse. Madje, sipas tij, ky pajtim mund ta parashihte edhe një marrëveshje për zgjedhjet e ardhshme lokale. Bislimi ka deklaruar se nëse këto dy subjekte politike arrijnë t'i kalkulojnë përfitimet kombëtare dhe afatgjata nga një bashkim i tillë, atëherë koalicioni mes tyre është lehtë i arritshëm

## Subjektet politike shprehin pëlqimet për koalicione parazgjedhore

Ndonëse ende nuk është shpërndarë Kuvendi si dhe nuk janë shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme, shumica e subjekteve politike kanë filluar t'i shprehin pëlqimet e tyre për koalicione parazgjedhore. Parimisht partitë janë deklaruar se do të garojnë të vetme, por pa përjashtuar koalicionet. Përderisa LDK-ja deri më tani nuk ka bërë publike pëlqimet, PDK-ja ka lënë të hapur opsionin për bashkëpunim me ndonjë subjekt të vogël. Kurse LV-ja është shprehur pro koalicionit me LDK-në, ndërkaq AAK-ja vazhdon të jetë e hapur për koalicion me Nismën, AKR-në dhe PSD-në FAQE 3

## Joseph: Zgjedhjet në Kosovë janë edhe referendum

FAQE 2



## AKTUALE



### BURRI E VRET GRUAN NË PRIZREN, INSTITUCIONET E VENDIT E DËNOJNË KËTË RAST F. 7

### BETOHEN 38 VULLNETARËT E KORPUSIT TË PAQES F. 6

### NË QKUK KRYHET OPERACIONI I PARË I PERDES SË LINDUR NË SYTË E FËMIJËS F. 6



## EKONOMI

### KËRKOHET QË KOMISIONI HETIMOR PËR PTK-në TA VAZHDOJË PUNËN EDHE NË LEGJISLATURËN E RE F. 9

### MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS KËRKON QË PUNONJËSIT E AEROPORTIT MOS TA NISIN PROTESTËN F. 8

## SPORT

### NËNSHKRUHET KONTRATA E PARË PAS HYRJES NË FUQI TË LIGJIT PËR SPONSORIZIM F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kapen 18 kilogramë drogë në kufirin Shqipëri - Mali i Zi

PODGORICË, 7 GUSHT - Zyrtarë policorë dhe doganorë të Malit të Zi kanë njoftuar se kanë kapur 18 kilogramë drogë në një makinë me targa të Shqipërisë në pikën kufitare Sukubinë - Muriqan. Sipas një njoftimi të përbashkët të Drejtorisë së Policisë dhe Drejtorisë së Tatimeve të Malit të Zi, personi D. K. (26 vjeç) nga Shkodra, i cili po drejtonte makinën e tipit "Mercedes Benz", u ndalua dhe dyshohet se tentoi të kontrabandonte marijuanë nga Shqipëria në Mal të Zi.
Droga gjendej në 35 paketime dhe ishte e fshehur në pjesë të ndryshme të makinës. "D. K., i cili u arrestua pasi në makinën e tij u gjet droga, iu dorëzua zyrtarëve të policisë kufitare të Shqipërisë për procedim të mëtejshëm", thuhet në njoftimin e policisë.
Policia malazeze në mënyrë të vazhdueshme ka bllokuar sasi të dukshme të drogës, të llojit marijuanë, e cila transportohet në forma të ndryshme drejt Malit të Zi. Zonat kufitare në mes të Malit të Zi dhe Shqipërisë, si Lumi Buna, Liqeni i Shkodrës, zona e Malësisë dhe ajo e Vermoshit konsiderohen territoret më të përshtatshme për trafikimin e lëndëve narkotike nga Shqipëria në drejtim të Malit të Zi dhe Evropës.



# Joseph: Zgjedhjet në Kosovë janë edhe referendum

PRISHTINË, 7 GUSHT - Zgjedhjet në Kosovë do të jenë pjesërisht edhe referendum për disa çështje siç është "shkëmbimi i territoreve", ka thënë, në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë", Edward Joseph, profesor i Universitetit "John Hopkins", i cili ka qenë edhe pjesëmarrës në misione të ndryshme në Ballkan gjatë dhe pas luftërave të viteve të '90-ta. "Serbia është në një situatë tjetër, sepse pozicioni i presidentit Aleksandar Vuçiq është shumë i fuqishëm. Ai kontrollon qeverinë, ka një ndikim të madh në media, gëzon mbështetjen e Rusisë. Pra, ai ka një pozicion shumë të fortë që i lejon atij të arrijë një marrëveshje për Kosovën", ka thënë Joseph.
Joseph thotë në këtë intervistë se ndryshimi i kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë është një skenar i rrezikshëm që nuk do ta zgjidhë mosmarrëveshjen në raportet mes tyre. "Përkundrazi, do ta komplikonte situatën, do t'i jepte fund pranisë së serbëve në jug të Kosovës, duke rrezikuar statusin e Deçanit, Graçanicës dhe pasurive të tjera të rëndësishme serbe. Kjo menjëherë do të hapte çështje më të gjera rajonale, siç është statusi i Sanxhakut dhe Republikës Serbe".
Megjithatë, analisti amerikan vlerëson se për çështjen e ndryshimit të kufijve ka qëndrime të ndryshme në



Uashington. "Për shembull, për dallim nga Bolton (John Bolton, këshilltari për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë) ekziston një pozicion tjetër i Departamentit të Shtetit, i cili thekson se çdo zgjidhje për Kosovën duhet ta marrë parasysh stabilitetin rajonal dhe shkëmbimi i territoreve sigurisht nuk kontribuon në stabilitetin e Ballkanit", ka thënë Joseph, duke shtuar se tashmë Boltoni ka sinjalizuar se e mbështet ndryshimin e kufijve si zgjidhje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
I pyetur për ndikimin që mund të ketë dorëheqja e Ramush Haradinajt në dialogun Kosovë - Serbi, Joseph ka theksuar se e ardhmja politike e Haradinajt është në duart e Gjykatës në Hagë. "Së pari, e ardhmja politike e ish-kryeministrit Haradinaj tani është në duart e Tribunalit të Hagës. Ai së pari përballet me çështje ligjore përpara se të përqendrohet në çështje politike", ka thënë Joseph.

# OSBE-ja i përgjigjet Metës: Dialogu, vetëm me pëlqimin e të gjitha palëve




TIRANË, 7 GUSHT - Në ditët e fundit të muajit korrik u bë publike një letër që presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ia kishte drejtuar OSBE-së për të ndërhyrë në mënyrë që ta zgjidhë krizën aktuale politike në vend.
Këtë të mërkurë presidenti Meta ka marrë një përgjigje nga OSBE-ja.
Në letër vlerësohet besimi që Meta kishte tek institucioni i OSBE-së, por theksohet se lehtësimi i dialogut mund të jetë i suksesshëm vetëm me pëlqimin dhe pjesëmarrjen e të gjitha palëve përkatëse përmes një procesi të gjerë kombëtar.
Më tej në letër shkruhet se: "OSBE-ja dhe institucionet e saj, brenda mandateve të tyre, do të jenë të gatshëm të ofrojnë mbështetje për një proces të tillë gjithëpërfshirës. Një mbështetje e tillë mund të përqendrohet, për shembull, në propozime për reforma konkrete, siç është reforma zgjedhore".

## I nxehti përfshin Ballkanin, në Shqipëri temperaturat deri në 40 gradë

TIRANË, 7 GUSHT - Vala e të nxehtit që mbërtheu kontinentin evropian, duke thyer rekorde, duket se tashmë po kthen sytë drejt rajonit të Ballkanit. Meteorologët kanë paralajmëruar nisjen e një tjetër vale, që këtë herë do të fokusohet mbi Mesdhe, me rrymat e nxehta afrikane që do të vazhdojnë deri pas mesit të gushtit. Në hark kohor vala pritet të jetë relativisht e gjatë.
Kulmi i të nxehtit do të regjistrohet të dielën dhe të mërkurën e ardhshme, ku temperaturat në Italinë e Jugut, por edhe në Shqipëri, mund të arrijnë deri në 40 gradë celsius. Mes së shtunës dhe së hënës së ardhshme i nxehti do të shtohet edhe më në veri, por do të qëndrojë rreth kufirit të 35 gradëve.
Sidoqoftë, deri atëherë, i nxehti në rajon do të jetë më i përmbajtur falë kalimit të një mase ajri të freskët nga Atlantiku.
Vala e fundit e të nxehtit ua mori jetën disa personave në Evropë, ku temperaturat në Francë arritën një rekord të ri prej 45.9 gradë celsiusësh. Për të nxehtin përvëlues meteorologët fajësuan masën e ajrit të nxehtë, e ardhur nga Afrika Veriore. Franca është shndërruar në vendin e shtatë në Evropë që kalon kufirin e 45 gradëve celsius, bashkë me Bullgarinë, Portugalinë, Italinë, Spanjën, Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut. (TCh)



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Subjektet politike shprehin pëlqimet për koalicione parazgjedhore

Ndonëse ende nuk është shpërndarë Kuvendi si dhe nuk janë shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme, shumica e subjekteve politike kanë filluar t'i shprehin pëlqimet e tyre për koalicione parazgjedhore. Parimisht partitë janë deklaruar se do të garojnë të vetme, por pa përjashtuar koalicionet. Përderisa LDK-ja deri më tani nuk ka bërë publike pëlqimet, PDK-ja ka lënë të hapur opsionin për bashkëpunim me ndonjë subjekt të vogël. Kurse LV-ja është shprehur pro koalicionit me LDK-në. Ndërkaq AAK-ja vazhdon të jetë e hapur për koalicion me Nismën, AKR-në dhe PSD-në




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 7 gusht** - Për dallim nga e kaluara, partitë politike qysh tani kanë nisur t'i shfaqin pëlqimet e tyre për koalicione parazgjedhore ani pse ende nuk është shpërndarë Kuvendi dhe nuk është caktuar data e zgjedhjeve të parakohshme. Në parim, shumica e subjekteve të mëdha synojnë të garojnë të vetmet në zgjedhjet e vjeshtës, megjithatë nuk e përjashtojnë mundësinë për koalicione.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është e vetmja që deri më tani nuk ka bërë publike nëse pëlqen të bëjë koalicion, por që zyrtarët e saj kanë bërë me dije se do të garojë e vetme. Madje deputeti i kësaj partie, Naser Rugova, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se partitë e mëdha duhet të garojnë të vetme në mënyrë që të shihet fuqia e tyre në elektorat. "Tri partitë më të mëdha në vend, LDK, PDK dhe LV, do të duhej të garojnë të vetme, pra të maten në popull dhe cila të dalë e para duhet ta qeverisë vendin. Gjithnjë e më shumë është vlerësim dhe mendim i artikuluar që LDK-ja të shkojë e vetme në këto zgjedhje sepse jemi të bindur në fitore. Është mendim i artikuluar në lidership, struktura dhe anëtarësi, që LDK-ja të shkojë e vetme në këto zgjedhje sepse lista e LDK-së do t'i ketë të gjitha potencialet që i nevojiten vendit. Besoj se LDK-ja do të garojë e vetme dhe do të dalë fituese", ka deklaruar Rugova.

Ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) edhe pse mendon t'i hyjë garës e vetme, nuk e ka hedhur poshtë opsionin për bashkëpunim me subjekte të vogla.

Zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo parti do të bëjë koalicion me qytetarët e Kosovës. "Mendoj se ky është një vendim që i takon kryetarit dhe kryesisë së PDK-së. Deri më tani nuk kemi pasur një debat të tillë, por parimisht mendojmë se duhet të shkojmë të vetëm në këto zgjedhje, ndoshta me ndonjë bashkëpunim me ndonjë subjekt më të vogël. Mirëpo, siç thashë, këto janë çështje që i takojnë kryesisë së PDK-së. Koalicioni i vetëm që ne kemi në këto zgjedhje është koalicioni me qytetarët e Kosovës, diçka që historikisht PDK-ja ka bërë edhe në të kaluarën", është shprehur Hoxhaj.

Për dallim nga e kaluara, më e zëshmja sa iu përket koalicioneve është treguar Lëvizja Vetëvendosje (LV). Lideri i kësaj partie, Albin Kurti, është shprehur pro koalicionit me LDK-në i cili, sipas tij, mund t'i fitojë 70 deputetë. "Duhet të fitojmë e do të fitojmë. Mirëpo, kësaj radhe është e mundur që të fitojmë edhe para zgjedhjeve. Po, mund të fitojmë pas zgjedhjeve, kur në natën e raportimeve të komisionarëve nga vendvotimet, ankthi na bëhet festë. Ama mund të fitojmë edhe para zgjedhjeve këtë herë. Koalicioni paraprak i opozitës së vërtetë të deridjeshme të bëhet qeveri e mirë e së nesërmes. Asisoj t'i kemi së paku 70 deputetë. Një partner i vogël pas zgjedhjeve do të ishte më shumë se i mjaftueshëm për shumicën absolute të 2/3 dhe gjithsesi i panevojshëm për shumicën e thjeshtë qeveritare", ka deklaruar Kurti duke shtuar se mund të fitojnë edhe pa betejë. "Mbase më mirë ashtu, sepse betejat e vërteta e të mëdha do t'i kemi pikërisht pas fitores. Sepse menjëherë duhet të ndryshojnë lajmet e mbrëmjes me qeverisjen tonë të re. Jo më skandale qeveritare, por luftim i krimit dhe korrupsionit. Jo më emigrim porsi eksod, por punësim pa diskriminim. E kështu me radhë...", është shprehur Kurti.

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka bërë me dije se mbetet e hapur për koalicione parazgjedhore me Nismën, AKR-në dhe PSD-në. Deputeti i Aleancës, Muharrem Nitaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se strukturat drejtuese të partisë pëlqejnë që AAK-ja të garojë e vetme në këto zgjedhje, megjithatë Nitaj ka thënë se nuk përjashtohet as mundësia e ndonjë koalicioni nëse do të vlerësohej i domosdoshëm. "Vullneti i strukturave drejtuese të partisë kryesisht është që të shkohet vetëm në këto zgjedhje. Ka shumë arsye për këtë, por kryesorja është që katër partitë më të mëdha ta dëshmojnë fuqinë e tyre elektorale si të vetme. Por, nuk përjashtohet as mundësia e ndonjë koalicioni nëse do të vlerësohej i domosdoshëm", ka theksuar ai, duke shtuar se nuk janë të mbyllura dyert për partitë me të cilat Aleanca ka pasur bashkëpunim korrekt. "E thashë që shumica nga strukturat drejtuese në parti, duke përfshirë edhe degët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i kanë dhënë një përparësi garës vetëm, por nuk janë mbyllur dyert për partitë me të cilat kemi pasur bashkëpunim korrekt. Sigurisht në mesin e tyre janë partitë që i ka përmendur kryeministri Haradinaj", ka thënë Nitaj.

Edhe Nisma Socialdemokrate është shprehur pro koalicioneve parazgjedhore. Madje kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës, Jakup Krasniqi, nuk e ka përjashtuar as koalicionin me PDK-në. Ai ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se Nisma nuk duhet ta përjashtonte mundësinë e koalicioneve me asnjë parti politike, përfshirë edhe PDK-në. Megjithatë, Krasniqi ka thënë se për të ndodhur një koalicion i tillë Nismës duhet t'i plotësohen disa kërkesa dhe në mesin e tyre është edhe kandidati për kryeministër. "1. Kandidati për kryeministër nga ky koalicion do të duhej të ishte një kandidat (shumë kompetent e jo si deri më tani) që nuk është kryetar i subjekteve politike (është e preferueshme). Mbase në një situatë të tillë, kandidati duhet të jetë nga Nisma Socialdemokrate, kandidati duhet të ketë përvojë politike dhe institucionale të njohur nga publiku ynë", ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se kërkesa e dytë është që lista e kandidatëve për deputetë duhet të miratohej edhe të nënshkruhej nga kandidati për kryeministër i cili duhet t'i njohë mirë kapacitetet politike, intelektuale, profesionale e kombëtare dhe jo vetëm të këtyre dy partive politike.

## Veseli: S'ka më kryeministër me qira

**Prishtinë, 7 gusht** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se partia e tij nuk përkrah një qeveri teknike dhe se zgjedhjet janë e vetmja mënyrë për të dalë nga kriza. Veseli, i cili mban postin e kryetarit të Kuvendit, ka thënë se PDK-ja dy herë ua ka dhënë postin e kryeministrit partive të tjera, siç ka thënë ai, me qira, dhe se një gjë e tillë nuk do të ndodhë në këto zgjedhje. Duke folur në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Veseli e ka quajtur këtë legjislaturë të papërgjegjshme. Ai ka thënë se ai është duke folur hapur për gabimet që i ka bërë partia e tij. "Gabimet të cilat i ka bërë Partia Demokratike e Kosovës unë jam duke i sanuar", ka thënë Veseli.



Flet për "Epokën e re", Besnik Bislimi

# Bashkëpunimi me LDK-në mund të



Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi, beson në një koalicion parazgjedhor me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se një bashkëpunim i tillë do të mund të përfshinte dy mandate qeverisëse. Madje, sipas tij, ky pajtim mund ta parashihte edhe një marrëveshje për zgjedhjet e ardhshme lokale. Bislimi ka deklaruar se nëse këto dy subjekte politike arrijnë t'i kalkulojnë përfitimet kombëtare dhe afatgjata nga një bashkim i tillë, atëherë koalicioni mes tyre është lehtë i arritshëm

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 GUSHT - Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Besnik Bislimi, ka bërë me dije se një koalicion parazgjedhor opozitar do të dërgonte një sinjal të fuqishëm te qytetarët për një erë të re të qeverisjes në Kosovë. Ai ka thënë se një bashkëpunim parazgjedhor LV-LDK do të ishte një shpresë për qytetarët e Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bislimi ka treguar se një pajtim i tillë do të mund të përfshinte dy mandate qeverisëse. "Për të siguruar një fitore bindëse edhe para datës së mbajtjes së zgjedhjeve, një fitore që do të dërgonte një sinjal të fuqishëm te qytetarët për një erë të re të qeverisjes në Kosovë, një koalicion parazgjedhor opozitar do të ishte rruga e duhur. Një pajtim i tillë do të mund të përfshinte dy mandate qeverisëse, e pse jo do të mund të përfshinte edhe një marrëveshje për fitoren në të gjitha komunat e Kosovës në zgjedhjet e ardhshme lokale", ka thënë Bislimi.

Ai ka treguar se nëse hiqet dorë nga interesat e ngushta nuk është i pamundshëm një koalicion i tillë. "Nëse dy subjektet politike arrijnë t'i kalkulojnë përfitimet kombëtare dhe afatgjata nga një bashkim i tillë forcash, por edhe aspektet pozitive që do të rezultonin edhe për vetë subjektet politike, atëherë koalicioni është lehtësisht i arritshëm. Natyrisht se mund të ketë rezistencë të brendshme nga elementë që mbase kanë përfitime të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga qeverisja e korruptuar, por shoh hapësirë për margjinalizim të tyre", është shprehur ai.

Bislimi ka folur edhe për kundërshtimin që ka hasur një bashkëpunim i tillë te zyrtarët e lartë në LDK. Sipas tij, individët me peshë e kanë kuptuar rëndësinë e një bashkëpunimi të tillë. "Tani që ka përfunduar me sukses procesi zgjedhor, besoj se rruga përpara do të jetë më e lehtë. Individët me peshë politike në LDK e kuptojnë rëndësinë e një bashkimi forcash për dy mandate", është shprehur Bislimi.

**"Epoka e re":** *Z. Bislimi, Kryesia e Kuvendit ka vendosur që më 22 gusht të mbahet seanca për shpërndarjen e Kuvendit. Lëvizja Vetëvendosje këtë datë e ka vlerësuar të largët. Pse?*

**Bislimi:** Para dorëheqjes së kryeministrit, përgjigjja standarde në kërkesat e opozitës për zgjedhje të parakohshme ka qenë se vendi është futur në procese shumë të rëndësishme ndërkombëtare, andaj shkuarja në zgjedhje do të krijonte një vakum të rrezikshëm, i cili do të

# përfshinte dy mandate qeverisëse



shfrytëzohej nga presidenti për ta shtyrë aventurën e tij të rrezikshme për këmbim territoresh. Për më tepër, vonesat eventuale deri në zgjedhjen e qeverisë së re do të mund të krijonin telashe në përpilimin e buxhetit për vitin 2020, buxhet ky i cili do të duhej t'i reflektonte prioritetet e qeverisë së re dhe modelin e saj zhvillimor. Tani kemi një situatë të pakuptimtë ku, të paktën publikisht, të gjitha subjektet deklarohen se duan zgjedhje të parakohshme, e vetë kryetari i Kuvendit zvarritë panevojshëm shpërndarjen e Kuvendit. Kjo pastaj logjikisht edhe ngjallë dyshime për skenarë tipikë të PDK-së për t'i vënë në përdorim të gjitha makinacionet apo zbrazëtitë eventuale në Kushtetutë për ta deformuar vullnetin politik në interes të PDK-së. Kjo sidomos në rrethanat aq të pafavorshme për PDK-në që, siç duket, ka përshpejtuar procesin e demolimit të brendshëm politik.

**"Epoka e re":** *Sa është e gatshme për këto zgjedhje lëvizja dhe cilat janë pritjet e saj nga ky proces?*

**Bislimi:** Jo vetëm Lëvizja, por besoj edhe qytetarët janë duke i parë zgjedhjet e parakohshme si mundësinë e vetme për parandalimin e kësaj qeverie kusarësh. Mendoj se burimi kryesor i gjithë këtyre zvarritjeve dhe tentativave për skenarë të papërgjegjshëm që do t'i parandalonin zgjedhjet, qëndron te përgatitja shumë e mirë e Lëvizjes dhe faktit që PAN-istët nuk po parashohin asnjë skenar të mundshëm që do ta linte Vetëvendosjen jashtë qeverisë së re, apo parandalonin PDK-në nga shkuarja në opozitë (e ndoshta edhe më keq se kjo!).

**"Epoka e re":** *Cili është disponimi në këtë subjekt politik, të shkohet vetëm në zgjedhje apo me ndonjë koalicion parazgjedhor?*

**Bislimi:** Lëvizja Vetëvendosje ka përsëritur disa herë qëndrimin e vet. Për të siguruar një fitore bindëse edhe para datës së mbajtjes së zgjedhjeve, një fitore që do të dërgonte një sinjal të fuqishëm te qytetarët për një erë të re të qeverisjes në Kosovë, një koalicion parazgjedhor opozitar do të ishte rruga e duhur. Një pajtim i tillë do të mund t'i përfshinte dy mandate qeverisëse, pse jo do të mund të përfshinte edhe një marrëveshje për fitoren në të gjitha komunat e Kosovës në zgjedhjet e ardhshme lokale. Por nuk e shohim aspak problematik as garimin individual, nisur nga fakti se Vetëvendosja edhe në zgjedhjet e kaluara ka vepruar njësoj dhe ka arritur të dalë fitimtare.

**"Epoka e re":** *Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Kurti, vazhdimisht po bën thirrje për një koalicion parazgjedhor me LDK-në. Pse gjithë ky insistim dhe sa është i mundshëm një koalicion i tillë?*

**Bislimi:** Ashtu si edhe u përmend në pyetjen paraprake, një koalicion i tillë do të siguronte një fitore të fuqishme që do t'i ngjallte shpresat te qytetarët, të cilët kjo qeveri dhe ato para saj i kanë lënë vetëm një perspektivë, atë të ikjes ilegale nga vendi. Nëse dy subjektet politike arrijnë t'i kalkulojnë përfitimet kombëtare dhe afatgjata nga një bashkim të tillë forcash, por edhe aspektet pozitive që do të rezultonin edhe për vetë subjektet politike, atëherë koalicioni është lehtësisht i arritshëm. Natyrisht se mund të ketë rezistencë të brendshme nga elementë që, mbase, kanë përfitime të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga qeverisja e korruptuar, por shoh hapësirë për margjinalizim të tyre.

**"Epoka e re":** *Shumë zyrtarë të lartë të LDK-së kanë bërë me dije se, pavarësisht prej koalicioneve, kjo parti nuk e jep postin e kryeministrit. A është e gatshme LV-ja t'ia japë postin e kryeministrit LDK-së para zgjedhjeve?*

**Bislimi:** LDK-ja deri më tani ka qenë në proces të brendshëm zgjedhor. Në të njëjtën kohë sondazhet e kanë radhitur si subjektin e parë në zgjedhje, edhe pse me një përparësi shumë të lehtë ndaj Vetëvendosjes. Tani që ka përfunduar me sukses procesi zgjedhor, besoj se rruga përpara do të jetë më e lehtë. Individët me peshë politike në LDK e kuptojnë rëndësinë e një bashkimi forcash për dy mandate, ashtu siç e kuptojnë që sondazhet jashtë fushate nuk përbëjnë ndonjë kriter relevant për ndarjen e roleve në marrëveshjet e ndërtimit të koalicionit. Plus që edhe sondazhet do ta ndryshojnë kahun përfundimisht që nga mesi i kësaj jave. Pozita e kryeministrit nuk është aspekt prestigji apo privilegji, por më tepër element i rëndësishëm në sinjalizimin e kahut që do të merr qeveria e re. Në një vend ku nepotizimi e korrupsioni janë avancuar në vlera dhe standard i politikbërjes dhe në pamundësue të çfarëdo iniciative inovative biznesore, është shumë me rëndësi që qeveria e re ta dërgojë prerazi dhe pa asnjë dyshim sinjalin e vendosjes së luftës ndaj krimit e korrupsionit si prioritet mbi prioritetet e angazhimit të saj.

# Gjykata Penale e Shkupit: Tomor Morina nuk duhet të ekstradohet në Serbi

Shkup, 7 gusht - Gjykata Penale e Shkupit ka dhënë mendimin lidhur me ish-pjesëtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Tomor Morina. Sipas gjykatës, Morina nuk duhet të ekstradohet në Serbi. Gjykata konsideron se në rastin në fjalë nuk janë përmbushur kushtet për ekstradimin e Morinës, ndërsa mendimin, me gjithë dokumentacionin, përfshirë edhe kërkesën serbe, e ka dërguar për shqyrtim të mëtejmë në Gjykatën Supreme. Gjithashtu, Gjykata Penale e ka lënë në fuqi masën e paraburgimit deri në përfundimin e gjithë procedurës. Morina ishte arrestuar nga policia maqedonase më 24 korrik, bazuar në një fletarrestim të Interpolit, të lëshuar me kërkesë të Serbisë. Ish-pjesëtari i UÇK-së, që aktualisht gjendet në burgun e Shkupit, dyshohet nga ana e autoriteteve të Serbisë se para 20 vjetëve ka kryer krime kundër popullatës civile në Kosovë.



## Në QKUK kryhet operacioni i parë i perdes së lindur në sytë e fëmijës

**PRISHTINË, 7 GUSHT (ER)** - Mjekët e Klinikës së Syve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë kryer për herë të parë te një fëmijë i moshës 11 muajsh operacionin e kataraktës kongjenitale (perdes së lindur në sy).
E. O., e lindur në vitin 2018, nuk ka pasur nevojë të dërgohet jashtë institucioneve publike shëndetësore pasi mjekët e kanë operuar atë në klinikë pas ardhjes së aparaturës së re mjekësore.
Në mungesë të aparaturës, rastet e tilla ishin referuar për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore, duke paguar deri në 5 000 euro.
Klinika e Syve tashmë ka staf të përgatitur dhe aparatura për kryerjen operacioneve të tilla dhe pacientët nuk do të kenë nevojë të referohen për trajtim jashtë QKUK-së.



# Nismës Socialdemokrate i bashkohen disa të rinj




**PRISHTINË, 7 GUSHT (ER)** - Nismës Socialdemokrate të mërkurën i janë bashkuar disa anëtarë në rinj. Në mesin e tyre edhe Valentina Shala-Bajrami, magjistre për marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci dhe kandidate për deputete nga radhët e AAK-së. Mirëseardhje anëtarëve të rinj u ka uruar kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Ai u ka shprehur mirënjohje dhe respekt për vendimin e tyre për t'iu bashkuar Nismës. "Nisma është shtëpia juaj. Nisma është një organizatë politike që angazhohet për drejtësi dhe solidaritet. Ne duam dhe angazhohemi që të jemi zëri i punëtorit, i të riut dhe gruas, pensionistit dhe të gjithë njerëzve që kanë nevojë për ndihmën e shtetit", ka thënë Limaj.
Më tutje, kreu i Nismës ka thënë se ai nuk e do votën e sharjes, por votën e zemrës.
Ai ka thënë se nuk janë parti që rrahin gjoks dhe shajnë të tjerët. Angazhimi kryesor i tij është eliminimi i padrejtësive.
Valentina Shala-Bajrami ka falënderuar kryetarin Limaj që ia ka hapur derën e Nismës Socialdemokrate asaj dhe bashkëpunëtorëve të saj. Ajo ka thënë se nga tani është rreshtuar prapa Nismës dhe bashkërisht do t'i kalojnë me sukses sfidat e ardhshme zgjedhore. "Ju bëj thirrje që bashkërisht të ecim tutje dhe programin socialdemokrat të Nismës ta përçojmë në secilën shtëpi të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Valentina Shala-Bajrami.
Nismës Socialdemokrate në muajt e fundit i janë bashkuar më shumë se 2 000 anëtarë të rinj.

# Betohen 38 vullnetarët e Korpusit të Paqes



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të mërkurën në betimin solemn të shërbimit për 38 vullnetarë të rinj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të Korpusit të Paqes në Kosovë. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, drejtoresha e Korpusit të Paqes, Darlene Grant, anëtarë të familjeve nikoqire.
Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se miqësia e popullit të Kosovës për atë amerikan është e mbjellë në gjithçka që Amerika ka bërë për Kosovën. "Programi juaj që po ofrohet në bazë vullnetare, me fokus ofrimin e ndihmës për shoqëritë e vendeve të ndryshme, duke ofruar informacion për kulturën dhe traditën amerikane dhe njëkohësisht njohjen dhe traditën e popujve nikoqirë, tashmë ka zënë vend edhe në Kosovë, për çka ju jemi mirënjohës", ka thënë ministri Bytyqi.
Ministri Bytyqi ka folur edhe për ndihmën e madhe që ka dhënë ShBA-ja për procese të rëndësishme në arsim si dhe për mbështetjen e mësimdhënësve përmes programit të Korpusit të Paqes. Kjo ceremoni ishte kurorëzim i punës dhe përkushtimit të 38 vullnetarëve pas përfundimit të trajnimit të tyre prej dhjetë javësh për gjuhën, kulturën si dhe trajnime teknike.

## Havolli i dhuron mirënjohje O'Connellit për kontributin e dhënë për AKK-në

**PRISHTINË, 7 GUSHT (ER)** - Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, është takuar të mërkurën me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell. Havolli ka shprehur mirënjohje dhe falënderime për kontributin e Ambasadës Britanike në Kosovë për mbështetjen e institucioneve të Kosovës, veçanërisht për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.
Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell, gjatë takimit me drejtorin e AKK-së ka falënderuar Havollin për bashkëpunimin, duke theksuar se roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit duhet të jetë kyç në raport me vendimet për zbatimin e ligjit dhe integritetin e institucioneve publike.
Ambasadori Ruairi O'Connell gjithashtu ka shprehur përkushtimin e Ambasadës Britanike për bashkëpunim me Agjencinë Kundër Korrupsionit edhe në të ardhmen.
Në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë për AKK-në, Havolli i ka dhuruar një mirënjohje O'Connellit.



# Burri e vret gruan në Prizren, institucionet e vendit e dënojnë këtë rast

Policia e Kosovës ka njoftuar se një grua është vrarë në orët e vona të së martës në Prizren. Sipas njoftimit, rasti ka ndodhur në orën 23:00 në Rrugën "Hysni Morina" në Prizren. Bazuar në njoftimin e policisë, i dyshuari B. V. për "vrasje të rëndë" është bashkëshorti i saj

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRIZREN, 7 GUSHT - Më 6 gusht, pas orës 23:00, në rrugën "Hysni Morina" në Prizren, qendra e thirrjeve në Policinë e Kosovës ka marrë një informacion për një plagosje. Pas intervenimit nga policia dhe emergjenca e Prizrenit, të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes, është konstatuar për lëndimin e një viktime femër për të cilën mjeku ka konstatuar vdekjen si pasojë e lëndimit nga arma e zjarrit.

Njësitë e hetimeve dhe krimteknika në vendin e ngjarjes kanë gjetur viktimën si dhe 15 gëzhoja të kalibrit 9 mm. Me vendim të prokurorit është bastisur shtëpia e personit të dyshuar dhe policia ka arritur të gjejë armën e tipit revole ZIG M1, të kalibrit 9 mm si dhe 42 fishekë të kësaj arme. "Dyshohet se me të njëjtën armë i dyshimti ka kryer veprën penale të 'vrasjes së rëndë'. I dyshimti dhe viktima kanë qenë bashkëshortë", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Në këtë rast është ndaluar në afat prej 48 orësh personi i dyshimtë B. V., i lindur në vitin 1958.

Me vendim të prokurorit të shtetit trupi i pajetë është dërguar në IML për procedura të mëtutjeshme hetimore. Me rastin po merren njësitë e hetimeve rajonale në Prizren.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dënuar vrasjen e Armenda Aliut në Prizren dhe ka bërë thirrje që të ndalet dhuna në familje. Ai ka thënë se nuk mund të ketë asnjë arsye për të ushtruar dhunë në familje e aq më pak për të marrë një jetë njeriu. "Dhuna në familje është e papranueshme dhe duhet ndalur menjëherë. Shpreh keqardhje të thellë për rastin e fundit në Prizren, kurse familjes i shpreh ngushëllime në këto çaste shumë të vështira. Nuk mund të ketë asnjë arsye për të ushtruar dhunë në familje e aq më pak për të marrë një jetë njeriu. Le të jetë kjo thirrje jo vetëm për organet e drejtësisë, por për tërë shoqërinë që të ndalet dhuna", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndaj këtij rasti ka reaguar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Ai ka thënë se ngjarja e rëndë e vrasjes në Prizren është një akt i papranueshëm të cilin e ka dënuar fuqishëm. "Dhuna në familje dhe keqtrajtimi i grave janë fenomene që shkojnë ndesh me vlerat tradicionale të familjes sonë si dhe me të drejtat themelore të njeriut. Gratë në Kosovë kanë qenë në vazhdimësi subjekt i diskriminimit, abuzimit dhe dhunës. Me këtë rast i bëj thirrje policisë dhe institucioneve të drejtësisë që ta japin përgjigjen e merituar për këtë rast të dhimbshëm dhe që çështjet që lidhen me dhunën ndaj grave t'i trajtojnë me përparësi dhe përkushtim të veçantë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shtuar se neglizhenca dhe indiferenca e institucioneve shtetërore të ligjit ndaj grave të kanosura apo thirrjeve të grave për ndihmë nuk do të tolerohen më.

Edhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se është thellë i prekur nga vdekja tragjike e Armenda Aliut. "Thellë i prekur nga vdekja tragjike e Armenda Aliut, mikes sonë dhe nënës së koleges nga kabineti Diellza Hoti. Ngushëllime familjes dhe miqve! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndaj kësaj vrasje ka reaguar edhe Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit. "Dhuna në familje është një akt kriminal i dënueshëm dhe i kobshëm. Akti i tillë dhe aktet e tjera të dhunës dhe ngacmimit seksual që kanë ndodhur në këta muajt e fundit janë të papranueshëm për ne si Agjenci, por dhe si shoqëri. Aktet e dhunës dhe kryerësit e tyre duhet të dënohen penalisht nga organet e drejtësisë dhe moralisht nga gjithë shoqëria jonë. Agjencia për Barazi Gjinore tërheq vëmendjen e institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile, komuniteteve, mbarë shoqërisë për praninë e shtuar të armëve në pronësi të qytetarëve dhe sjelljeve të dhunshme dhe agresive të cilat po rezultojnë në humbjen e jetëve të qytetareve, mosgëzimin e të drejtave dhe mosrespektimin e dinjitetit, në mënyrë të veçantë të grave, nënave, motrave dhe bijave tona", është thënë në reagimin e Agjencisë për Barazi Gjinore.




## Drejtori i përgjithshëm i policisë viziton pikën kufitare në Vërmicë

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, i shoqëruar nga stafi i tij, drejtori i Departamentit të Policisë Kufitare, Shaban Guda dhe drejtori i Divizionit të Trafikut, nënkolonel Jeton Rexhepi, ka vizituar të mërkurën pikën kufitare në Vërmicë si dhe kanë inspektuar njësitet policore të PK-së, të cilat, sipas marrëveshjes së mirëkuptimit, kryejnë patrullime të përbashkëta me zyrtarët policorë të shtetit të Shqipërisë.

Gjatë kësaj vizite u realizua një takim i përbashkët edhe me zyrtarët policorë të autoriteteve të Shqipërisë, të cilët informuan menaxhmentin e lartë mbi punën, aktivitetet dhe angazhimet policore të cilat ndërlidhen me menaxhimin dhe kontrollin e kufirit, duke veçuar edhe kontrollin e lehtësuar kufitar për shkak të qarkullimit të madh të qytetarëve dhe automjeteve gjatë sezonit veror.

Pjesë e kësaj vizite ishte edhe inspektimi i njësiteve policore që, sipas marrëveshjes së mirëkuptimit në mes të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Kosovës, kryejnë patrullime të përbashkëta në shtetin shqiptar.

Ky takim zyrtar në mes të dy palëve ka rezultuar mjaft pozitiv dhe si synim ka ngritjen dhe avancimin e mëtejmë të bashkëpunimit policor në mes të dy vendeve.



# OAK-u i bën thirrje qeverisë për ndryshimin e udhëzimeve administrative

**Prishtinë, 7 gusht (ER)** - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka mbajtur konferencë për medie të mërkurën në lidhje me problemet me të cilat po hasin bizneset që kanë të bëjnë me Ligjin për Miniera dhe Minerale. Në këtë konferencë është kërkuar ndryshimi i udhëzimeve administrative të Ministrisë së Bujqësisë.

Mirjeta Shala, zyrtare për komunikim me biznese, ka kërkuar që Ligji për Miniera dhe Minerale të kthehet edhe një herë në dëgjim publik. "Kërkesë jona është që Ligji për Miniera dhe Minerale të kthehet edhe një herë në dëgjim publik. I bëjmë thirrje kryeministrit dhe ministres së Bujqësisë që t'i ndryshojnë udhëzimet administrative që do të kishte pastaj ndikim në zhvillimin e vendit", është shprehur Shala.

Në këtë konferencë OAK-u ka kërkuar që të largohet edhe vendimi për 'Ndalimin e përkohshëm të ndërrimit të pasurisë së paluajtshme'. "Oda e Afarizmit kërkon që të largohet edhe 'Vendimi për ndalimin e përkohshëm të ndërrimit të pasurisë së paluajtshme të MBPZhR-së', i datës 20. 07. 2010. Duke pasur parasysh dëmtimin që po iu bëhet këtyre bizneseve dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik të Kosovës nga mosharmonizimi i ligjeve me udhëzimet administrative me njëra-tjetrën, Oda e Afarizmit përsërit kërkesën për marrjen e hapave më të shpejtë për përmirësimin e kësaj situate", ka deklaruar Rreze Cana, zyrtare për komunikim me biznese.



# AKP-ja dhe Komuna e Prishtinës nënshkruan marrëveshje për pagesën e shpronësimit të N. Sh. 'Gërmia' dhe N. Sh. 'Slloga'

EPOKA E RE **A. MAVRAJ**

**Prishtinë, 7 gusht** - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe Komuna e Prishtinës kanë arritur marrëveshje mirëkuptimi për pagesën e shpronësimit të ndërtesës "Shtëpia e re e Mallrave", pronë e ndërmarrjes shoqërore "Gërmia" dhe për një pjesë të tokës së ndërmarrjes shoqërore "Slloga (KHT Kosova).

Marrëveshja në fjalë është nënshkruar të mërkurën në selinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nga drejtori menaxhues i AKP-së, Valon Tolaj dhe nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli. Ndërtesa "Shtëpia e Re e Mallrave" është shpronësuar në muajin gusht të vitit të kaluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për interes publik.

Ministria e Financave e ka bërë vlerësimin e pronës së ndërtesës, drunjve pyjorë dhe drunjve frutorë në shumën prej 5,873,155 eurosh për ndërtesën dhe shpronësimin në shumën prej 152,490 eurosh të një pjesë të tokës (170 m2) për Ndërmarrjen Shoqërore "Slloga" (KHT Kosova).

Sipas qëndrimit të qeverisë, Komuna e Prishtinës obligohet të jetë pjesë e pagesave gjatë procedurës së bartjes së pronës në komunë. Komuna është përcaktuar si organ përgjegjës për zbatimin e kompensimit për punëtorët e N. Sh.-ve sipas legjislacionit në fuqi, pra ta kryejë këtë



obligim për punëtorët duke transferuar mjetet monetare në llogarinë e AKP-së si dhe pagesat eventuale për kreditorët e N. Sh.-ve përkatëse. Obligimet për nivelin e pagesës për shpronësimet e pronave shoqërore përcaktohen në nenin 6A të ligjit të AKP-së.

Për ndërtesën "Shtëpia e re e mallrave" 20 për qind e shumës për pagesë për punëtorët e N. Sh.-ve është 1,174,631 euro, ndërsa për tokën e N. Sh. "Slloga", ndërlidhur me objektin e "Gërmisë" në Prishtinë, 20 për qind e shumës për pagesë për punëtorët e N. Sh.-ve është 30,498 euro.

Me marrëveshjen e nënshkruar Komuna e Prishtinës ka marrë obligim që pagesa e mjeteve për 20 për qind për punëtorët e N. Sh. "Gërmia" të bëhet brenda viteve 2019, 2020 dhe vitit 2021, dhe atë këstit i parë në muajin tetor 2019, kësti i dytë në muajin shkurt 2020 dhe kësti i tretë në muajin shkurt 2021. Ndërkaq, për punëtorët e N. Sh. "Slloga" (KHT Kosova) pagesa e 20 për qind nga komuna do të bëhet në llogari të AKP-së deri në muajin tetor të këtij viti 2019.

## Ministria e Infrastrukturës kërkon që punonjësit e aeroportit mos t'i fillojnë protestat



**Prishtinë, 7 gusht (ER)** - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka pranuar me shqetësim paralajmërimet e Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve të Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" për fillimin e protestave. "Apelojmë te të dyja palët, te drejtuesit e sindikatës dhe të aeroportit, që të diskutojnë rreth zgjidhjes së problemeve për të cilat punëtorët janë të pakënaqur. Njëkohësisht, MIT në krye me ministrin Pal Lekaj i bën thirrje konsorciumit 'Limak' që t'i respektojë me përpikëri ligjet e Republikës së Kosovës dhe kontratën për koncesionimin e ANP 'Adem Jashari'. Konsiderojmë se është e dëmshme ndalja e punës nga ana e punonjësve të aeroportit, pikërisht në kohën e fluksit më të madh të udhëtarëve, veçanërisht diasporës. Këto qëndrime, te të dyja palët, në takime të ndara, i përcolli zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

# Kërkohet që Komisioni Hetimor për PTK-në ta vazhdojë punën edhe në legjislaturën e re

Në mbledhjen e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala është konstatuar se ky komision duhet ta vazhdojë punën edhe në legjislaturën e ardhshme dhe mos t'i dërgohet raport Kuvendit, por vetëm të votohet një draftraport ku legjislatura e ardhshme do të kishte një pikënisje për punën e deritanishme

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 GUSHT - Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala ka diskutuar të mërkurën në lidhje me mënyrën e vazhdimit të punës pas rrethanave të reja të krijuara lidhur me shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Me këtë rast u tha se komisioni hetimor duhet ta vazhdojë punën edhe në legjislaturën e ardhshme dhe mos t'i dërgohet raport Kuvendit, por vetëm të votohet një draftraport ku legjislatura e ardhshme do të kishte një pikënisje për punën e deritanishme. Komisioni, gjithashtu, ka vendosur që ta përmbyllë fazën e intervistimit dhe të kalohet në fazën e përpilimit. Po ashtu, deputetët thanë se edhe pse puna e tyre është përfunduar vetëm 30 për qind, prokuroria ka bazë në dokumentacionet e tyre që të iniciojnë kallëzime penale. Kryetari i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala, Visar Ymeri, ka paraqitur dy mundësi që komisioni para shpërndarjes së Kuvendit të paraqesë një raport dhe të votohet ose të vazhdohet hetimi në legjislaturën e ardhshme. Ymeri ka deklaruar se ky hetim duhet të vazhdohet në legjislaturën e ardhshme pasi, siç ka thënë ai, raporti i shpejtë mund të ketë mangësi. "Më mirë është të lihet i hapur për legjislaturën e ardhshme pasi, nëse e përfundojmë shpejt raportin, atëherë ai do të kishte mangësi", është shprehur Ymeri.

Këtë kërkesë e ka mbështetur deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, i cili ka theksuar se deri më tani kanë intervistuar vetëm 30 për qind të dëshmitarëve dhe se hetimet duhet të vazhdojnë në mandatin e ardhshëm. Me këtë konstatim të Haxhiut është pajtuar edhe deputeti i LDK-së, Armend Zemaj. Kërkesë të njëjtë kishte edhe deputeti Milaim Zeka dhe ai i AAK-së, Shkumbim Demaliaj. Në fund u tha se para votimit të mënyrës si të vendoset, duhet të mbahen edhe dy mbledhje për të votuar mbi mënyrën se si do të vendoset.



## Kosovës po i shtohen 28 inxhiniere të elektros

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, ka bërë me dije se Kosovës po i shtohen 28 inxhiniere të elektros. "Jam jashtëzakonisht i lumtur që Kosovës po i shtohen gradualisht 28 inxhiniere të elektros. Sapo kanë arritur në Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës 28 supervajzat nga Kosova të cilat kanë fituar bursë të plotë për të studiuar në fushën e inxhinierisë elektroteknike. Këto bursa janë mundësuar duke iu falënderuar Qeverisë Amerikane përmes programit të Millennium Challenge Corporation -MCC dhe Millennium Foundation Kosovo. Si ministër përgjegjës për zhvillimin e sektorit energjetik dhe si anëtar i bordit të Millennium Foundation Kosovo, ju uroj të gjitha 28 supervajzave suksese të përzemërta. Kosova do të ketë nevojë për shkathtësi të tyre dhe mendoj se ky moment do të shënohet në historinë e elektroenergjetikës", ka shkruar Lluka në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se me iniciativën e tij shumë shpejt do të ketë bursa edhe për programin e doktoraturës në Amerikë dhe Evropë, për të plotësuar nevojat e kuadrove në Kosovë. "Faleminderit të gjithëve që kanë punuar në këtë drejtim, e sidomos ekipit të Millennium Foundation Kosovo!", ka shkruar Lluka.



## Komuna e Rahovecit ndan 15 000 euro për Festivalin "Hardh Fest"

RAHOVEC, 7 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim kryetarin e Bordit të Organizatës "Hardh Fest", Agron Sokoli, me të cilin kanë nënshkruar marrëveshjen për subvencionimin e Festivalit "Hardh Fest" për edicionin 2019. "Komuna e Rahovecit dhe unë si kryetar, duke parë suksesin dhe profesionalizimin në organizimin dhe mbarëvajtjen nga edicionet e kaluara, kemi rritur buxhetin për këtë festival në vlerën prej 15 000 eurosh. Festivali ka arritur që për kohë të shkurtër të ndërkombëtarizohet, duke sjellë turistë të shumtë nga shtetet e rajonit, Evropës, por edhe nga shtetet e tjera të botës", ka thënë Latifi.

Ai ka thënë se mbështetja e tij si kryetar komune dhe e institucioneve lokale do të rritet në vitet e ardhshme pasi që festivali "Hardh Fest" është një nga organizimet më të mëdha në Kosovë. "Me rëndësi të veçantë në promovimin e produkteve bujqësore, vlerave të trashëgimisë kulturore dhe turizmit që ka vendi ynë", ka thënë kryetari Latifi.



# Komuna e Malishevës dhe KDI-ja kanë filluar mbajtjen e dëgjimeve publike për buxhet

MALISHEVË, 7 GUSHT (ER) - Komuna e Malishevës, në bashkëpunim me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), kanë filluar mbajtjen e takimeve me qytetarë, në vendbanime, në kuadër të mbajtjes së dëgjimeve publike, për hartimin e projektbuxhetit 2020-2022, me theks të veçantë për hartimin e buxhetit për vitin 2020.

Të mërkurën janë mbajtur takime me banorët në fshatrat Temeqinë dhe Kërvasari. Përmes këtyre takimeve me qytetarë nëpër vendbanime, synohet që të arrihet nxjerrja e nevojave dhe prioriteteve që kanë vendbanimet, në mënyrë që përmes kërkesave të marra drejtpërdrejt nga qytetarët dhe grupet e tjera të interesit, të hartohen prioritetet për investimet kapitale që do të parashihen për vitin 2020, por edhe për prioritetet për tre vjetët në vazhdim, sipas qarkores buxhetore.

Në këto takime bashkë me zyrtarët e KDI-së ka marrë pjesë edhe drejtori komunal për buxhet dhe financa, Valon Mazreku, i cili u ka sqaruar qytetarëve për mundësitë buxhetore që parashihen, në mënyrë të veçantë për investimet kapitale. Në këto takime drejtori Mazreku i ka marrë të gjitha kërkesat e banorëve të këtyre dy fshatrave, ndërsa takimet do të vazhdojnë në ditët në vijim, në fshatrat dhe vendbanimet e tjera dhe, në fund të takimeve, do të hartohet edhe lista e investimeve kapitale bazuar në kërkesat dhe prioritetet që kanë qytetarët e Komunës së Malishevës.



# Do të revitalizohet objekti i braktisur në lagjen e Kacallarëve në Prishtinë



PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, dhe përfaqësuesit e konsorciumit të organizatave Shtatëmbëdhjetë, Cultural Heritage without Borders /Fondacioni Trashëgimia pa Kufij (CHwB) dhe Qendra Multimedia kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për revitalizimin e objektit të braktisur në lagjen e Kacallarëve në Prishtinë.

Marrëveshja, përveç revitalizimit të vet objektit, parasheh edhe shndërrimin e këtij objekti në hapësirë shumëfunksionale dhe Qendër të Artit për Komunitetin, ku edhe do të ofrohen programe vjetore në fushën e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore e aktivizmit qytetar. Objekti gjendet në njërën prej lagjeve më të vjetra të kryeqytetit dhe është ndërtuar në shekullin e kaluar nga atdhetari Shyqri Begu.

Përgjatë viteve është shfrytëzuar për destinime të ndryshme, ku pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë burg i policisë serbe e më vonë klub i boksit, në vitet e '60-ta i shërbeu Entit të Botimeve, kurse më vonë u shfrytëzua si objekt banimi.

## Objekti i maternitetit në Lipjan me pamje tjetër

LIPJAN, 7 GUSHT (ER) - Objekti i maternitetit në kuadër të Gjinekologjisë në Lipjan tanimë ka një pamje tjetër pas një investimi që ka bërë Komuna e Lipjanit duke bërë renovimin e objektit. Këto investime, përveç që ofrojnë trajtim të dinjitetshëm për çdo grua dhe nënë, tanimë dukshëm kanë përmirësuar kushtet e punës për stafin shëndetësor të cilët për vite të tëra kanë punuar në kushte jo të mira. Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka thënë se do ta ketë prioritet sektorin e shëndetësisë.



Me rastin e një vjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (13)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Vepra Jote, puna Jote, na e bëri të mundshme që na, sot, lirshëm po ecim, po këndojmë e po flasim! Unë Shaban Baksi, jam mirënjohës për veprën Tënde!

29 korrik 2018,
Shaban Baksi

Vepra Juaj meriton respektin më të madh!

29 korrik 2018,
Jetullah Rushiti

Baca Adem, për neve je i pavdekshëm! Lavdi jetës dhe veprës Tuaj!

29 korrik 2018,
Muhamet Ahmeti

Në emër të fshatrave Arllat e Llapushnik, iu shprehu ngushëllime gjithë shqiptarëve për Mendelen e Kosovës, bacën Adem!

29 korrik 2018,
Ramadan Bytyqi

Njeriu i madh i kombit. Faleminderit për veprat Tuaja! Zoti iu shpërbleftë me të mirat e tij! Lavdi Bacë!

29 korrik 2018,
A. Lupçi

Sot ishim për të nderuar Kolosin e Kombit, z. Adem Demaçin! Atdheu do ia ruaj përjetë lavdinë dhe veprën!

29 korrik 2018,
Halit Shabani,
I. Mazreku, E. Veliu

Bacë, të qoftë i lehtë dheu i Shqipërisë Etnike! Bacë, Zoti të ndihmoftë!

29 korrik 2018,
Isak Lala - Rrebeli

Me veprën Tënde do vazhdojmë fitoret e reja! Na ndihmoftë zoti në rrugën tonë të drejtë! Lavdi të qoftë përjetë, Bacë!

29 korrik 2018,
Zejnullah Shala, Sedllar

Inspirim dhe thirrje e ndërgjegjes për të gjithë brezat, ishe Ti, Bacë Adem! Çka ishim sot po të mos të kishim Ty!

29 korrik 2018,
Fitim Selimi

Zoti të shpërbleftë me parajsë, o Baca Adem, që u sakrifikove për popullin shqiptar!

29 korrik 2018,
Musa Sherifi

Në këtë botë jetohet për një kujtim. Ke lënë vepra e kujtime të mira! Nuk të harrojmë, Bacë!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Kjo është ditë e veçantë për nderim të veçantë të njeriut të posaçëm që lind rrallë nder shekuj, e që gjithë jetën ia kushtoi formimit kombëtar dhe lirisë se popullit e të trojeve shqiptare. Të krahasojmë me Mendelen, por Ti për ne ishe shumë më tepër, i njohur si luftëtar i përkushtuar, për kauzën kombëtare! Lavdi të qoftë përjetë!

29 korrik 2018,
T. Marku

Lavdi veprës dhe jetës Suaj!

29 korrik 2018,
Idriz Gashi

Krenar me jetën dhe veprën Tënde, baca Adem!

29 korrik 2018,
V. Gusia

Lamtumirë Bacë! Lamtumirë Lisi i palëkundur nga asnjë furtunë e kohës! I gjithhershëm do mbetesh, Bacë!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Adem Demaçi, frymëzuesi ynë, frymëzuesi i Kombit!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I papërsëritshmi! I madhi ynë, Baca Adem! Jemi krenar që jetuam në Epokën Tënde!

29 korrik 2018,
Sh. Elezi

Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës Tuaj, bacës Adem, Hyjnorit të kombit tonë!

29 korrik 2018,
Bilall Kryeziu

Bacë, Ti ishe frymëzimi ynë për liri! Do mbetesh frymëzim sa të ekzistoj ky popull! I lehtë që qoftë dheu i Kosovës dhe i gjithë Shqipërisë!

29 korrik 2018,
Avdullah Dreni, Pejë

Bacë, na falë për vogëlsinë tonë! Lutu për ne, Bacë!

29 korrik 2018,
Dr. Fisnik Maqedonci

Hero që vazhdoi luftën e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe e mbaroi me fitore, me ç'rast, UÇK-së iu bash-kuan të gjitha shtetet e NATO-s! Adem Demaçi ishte ndërtues i madh, por në të njëjtën kohë edhe shkatërrues i armikut të jashtëm e të brendshëm, dhe një herë tha: "Kosovë, oj Nëna e dashur, më lejo të luftoi për Ty, se jam djalë i dheut Tënd!

27 korrik 2018,
Hakif Bajrami

Dhembja për Bacën Adem është e papërshkrueshme! Shoqërinë "Lëvizja" e ka tronditur kjo humbje e madhe, për kombin shqiptar! Ai ishte udhërrëfyes i shumë gjeneratave në luftë për liri! Ishte e do të mbetet udhërrëfyes deri në realizimin e plotë të të drejtave të shqiptarëve për liri e bashkim kombëtar!
Adem Demaçi, për shoqërinë Lëvizja, ishte dhe mbeti ura mbi të cilën kalon liria e Kosovës! Lavdi e përjetshme!

29 korrik 2018,
A. A. Shoqëria Lëvizja

Baca Adem ishe një Njeri i Madh i Kombit tonë të vogël! Ai ishte i të gjithëve pa dallim feje e partie! Zoti e shpërbleftë për veprën e tij të pakrahasueshme! Ngushëllime gjithë familjes Demaçi dhe të gjithë atyre që e duan edhe takimin me Te, në amshim!

29 korrik 2018,
R. Limani

Jemi krenar që jetuam në Epokën e juaj i dashuri Baca i madh Adem Demaçi, krenaria jonë! Gjithmonë do të na bëj krenar e të fortë të vazhdojmë rrugën tuaj, posaçërisht, neve gjithë bashkëpunëtorëve të Tij! Qoftë i përjetshëm kujtimi për Ty, Bacë!

29 korrik 2018,
Gani Vllahia

Baca Adem, pusho i qetë. Meritat Tuaja janë të përjetshme!

29 korrik 2018,
Miradije (mbiemri i palexueshëm)

Për mua, ishe atdhetari më i madh i kombit! Lavdi!

29 korrik 2018,
Igballe (mbiemri i palexueshëm)

Adem Demaçi ishte dhe mbetet ikona më emblemë e kombit shqiptar!

29 korrik 2018,
G. Bytyqi

Dikush vdes përgjithmonë, kurse dikush tjetër lind nga vdekja, andaj Baca, Adem, ngrihu në këmbë, dhe prina!

29 korrik 2018,
Adem (mbiemri i palexueshëm)

I vetëdijshëm për padrejtësitë që bënë fuqitë e mëdha kombit shqiptar, vendosi që të sakrifikojë rininë dhe jetën e tij për çlirimin dhe bashkimin kombëtar shqiptar! Lavdi e përjetshme veprës së Adem Demaçit!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem ishe një yll, që pos dritës tuaj shkuan të gjitha gjeneratat, '68 e '81 dhe të luftës çlirimtare që solli lirinë për popullin shqiptar. Je simbol i kombit, do të mbetesh në mendjen dhe zemrat tona përherë! Lavdi veprës Tuaj të përhershme!

29 korrik 2018,
Xhemile Hoti

Shoku im i klasës, i madhi Adem Demaçi, ka qenë inspirimi i im për çdo gjë që kam bërë gjatë gjithë jetës! Lavdi të qoftë përherë shoku Adem!

29 korrik 2018,
Prof. dr. Skënder Lushi

**(Vazhdon në numrin e ardhshëm)**



## Shpërthim i fuqishëm në Kabul, së paku 18 të vrarë


Hedayatullah Amid (EPA-EFE)

**Kabul, 7 gusht** - Të paktën 18 njerëz u vranë dhe 145 të tjerë u plagosën kur një makinë bombë shpërtheu para një stacioni të policisë në Kabul të Afganistanit. Në mesin e viktimave kishte gra dhe fëmijë, bëri me dije zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme, Nusrat Rahimi.
Talibanët pohuan përgjegjësinë përmes një deklarate, duke thënë se një nga sulmuesit vetëvrasës që e kreu sulmin kishte në shënjestër një "qendër rekrutimi".
Talibanët kanë shtuar sulmet ndaj forcave afgane të sigurisë. Pavarësisht prej bisedimeve të paqes midis talibanëve dhe Shteteve të Bashkuara, nuk ka pasur asnjë ulje të nivelit të dhunës në Afganistan.
Shtetet e Bashkuara po synojnë të arrijnë një marrëveshje me talibanët përmes së cilës do të mundësohej largimi i forcave të huaja nga Afganistani. Mirëpo, ShBA-ja kërkon garanci nga talibanët, se nuk do të lejojnë që Afganistani të bëhet vend i grumbullimit të terroristëve.
Në rast të arritjes së një marrëveshjeje, më pas do të fillonin negociatat brenda afgane për dhënien fund të luftës gati 18-vjeçare. Talibanët tash për tash refuzojnë të negociojnë me qeverinë afgane.

# FBI nis hetim për 'terrorizëm të brendshëm' në ShBA



**Uashington, 7 gusht** - Zyra Federale e Hetimit (FBI) në Shtetet e Bashkuara ka nisur një hetim të brendshëm për terrorizëm lidhur me të shtënat që kanë ndodhur në një festival të ushqimit në Kaliforni ditë më parë, duke lënë të vdekur tre persona. Zyrtarët kanë thënë se kanë zbuluar "listën e shënjestrave" të sulmuesit, Santino William Legan, në të cilën janë përfshirë ndërtesa fetare dhe federale.
Agjenti John Bennett ka thënë se Legan, 19-vjeçar, ka qenë duke "hulumtuar ideologji të dhunshme", mirëpo FBI-ja ende nuk i ka konfirmuar motivet e sulmit.
Megjithatë, policia amerikane është duke lidhur me ideologji edhe dy të shtëna të tjera me armë zjarri.
Një sulm në El Paso të Teksasit që ka ndodhur të shtunën, ka lënë të vdekur 22 persona dhe është duke u hetuar si rast i brendshëm terrorist.
Zyrtarët për zbatim të ligjit janë duke analizuar një dokument anti-hispanik që është publikuar online pak para sulmit.
Të martën FBI-ja ka thënë se edhe sulmuesi i Ohajos, ku kanë vdekur nëntë persona të dielën, ka përkrahur "ideologji të dhunshme". Mirëpo zyrtarët kanë thënë se nuk kanë gjetur nëse sulmi ka qenë i motivuar mbi bazë race.
Të shtënat me armë zjarri në Festivalin e Hudhrës në Gilroy kanë qenë të parat prej tri sulmeve që kanë ndodhur në tetë ditë në ShBA dhe kanë lënë të vdekur 34 persona, pa harruar edhe më shumë se 50 të plagosur.

# Turqia shkatërron më shumë se 300 000 libra



**Ankara, 7 gusht** - Më shumë se 300 000 libra janë hequr dhe më pas larguar nga shkollat dhe bibliotekat turke që pas përpjekjes për grushtshtetit tre vjet më parë, saktësisht më 2016.
Ministri i Arsimit, Ziya Selçuk, ka thënë se përgjatë nismës së qeverisë për të shfarosur çdo gjë që lidhet me Fethullah Gylenin, klerikun mysliman që akuzohet për nxitje të puçit janë shkatërruar 301 878 libra. Ndërkohë nga ana e tij, Gyleni e ka mohuar kategorikisht një përfshirje të mundshme.
Shifrat në fjalë u publikuan për herë të parë nga gazeta e mirënjohur "Hurriyet", krahas të cilave shfaqeshin edhe imazhe të djegies së librave.
Sipas uebsajtit "Turkey Purge", që cilësohet si "një grup i vogël gazetarësh të rinj që po përpiqen të jenë zëri i popullit turk në një regjim shtypës", në vitin 2016 u ndalua rreptësisht një libër matematike thjesht për faktin se në një prej kërkesave të librit, gjendeshin inicialet e Gylenit. Kështu, në ushtrim thuhej që studenti të shkonte nga pika 'F' në pikën 'G', çka u konsiderua nga autoritetet përkatëse krejtësisht e papranueshme dhe provokuese.
Në dhjetor të vitit 2016 gazeta turke "BurGun" ka zbuluar se ishin shkatërruar 1.8 milion libra shkollorë për t'u ribotuar më pas sërish, pasi përmbanin në tekst fjalën Pennsylvania, vendi ku aktualisht Gylen po jeton në ShBA.

## Kërkimet për rezerva të gazit tensionojnë raportet mes Turqisë dhe Qipros



Reuters

**Ankara, 7 gusht** - Anijet turke po vazhdojnë operacionet në Mesdheun Lindor dhe një anije tjetër do t'u bashkohet atyre këtë muaj. Kështu ka thënë ministri turk i Energjisë, Fatih Donmez.
Tensionet në mes të Turqisë dhe Qipros janë rritur për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me hulumtimet për burimet natyrore të gazit.
Dy vendet anëtare të BE-së kanë pasur mospajtime për vite të tëra lidhur me pronësinë e burimeve të gazit.
Ankaraja thotë se turqit qipriotë kanë të drejtë për një pjesë të burimeve.
Turqia kundërshton marrëveshjet që qeveria qipriote, e njohur ndërkombëtarisht, ka arritur me shtetet e tjera mesdhetare për zonat ekonomike detare.
Turqia ka dërguar dy anije shpuese, Fatih dhe Yavuz, si dhe një anije eksplorimi, për të operuar në ujërat jashtë ishullit të ndarë të Qipros, duke shkaktuar akuza nga Greqia se po dëmton sigurinë në rajon.
Operacionet e Turqisë në rajon kanë ngjallur një reagim nga aleatët e saj perëndimorë, përfshirë Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara.
Nikozia është në mosmarrëveshje me Turqinë që nga pushtimi turk më 1974, i cili ka ndarë ishullin në dy pjesë: Qipron greke, e cila njihet ndërkombëtarisht si Qipro, dhe rajonin separatist të Qipros turke. Qiproja turke njihet vetëm nga Turqia dhe është subjekt i sanksioneve ndërkombëtare.

Mbi romanin "Në Tiranë bie shi" të Kliton Nesturit

# EPOKA QË KRIJON QENIE AMORFE

Zyrafete SHALA

Romani "Në Tiranë bie shi", i botuar ditë më parë nga shtëpia botuese "OMSCA-1", është vepra e nëntë me radhë në krijimtarinë e Kliton Nesturit, i dëshmuar tanimë në letrat shqipe si poet, prozator, publicist dhe dramaturg. Duke qenë nga brezi i shkrimtarëve që në hapat e parë të ndërtimit të identitetit të tyre krijues, u përballën me shembjen e një epoke sfilitëse dhe fillimin e një tjetre përplot stuhi, Kliton Nesturi me kohë përvetësoi shkathtësinë e vrojtimit të thellë të dukurive, situatave e problemeve shoqërore të kohës. Krahas prirjes së tillë, që e njohim nga veprat e mëparshme, në këtë roman autori spikat edhe me mjeshtërinë për të depërtuar nëpër labirintet e errëta të shoqërisë shqiptare, aty ku shpeshherë janë tulatur forcat shkatërruese, në pritje të një periudhe të përshtatshme për të shpërthyer.
Romani "Në Tiranë bie shi" trajtohen realitetin aktual shqiptar me tërë absurditetin e tij, krizën morale të shoqërisë, përpjekjet e individit për të mbrojtur dinjitetin, si dhe vështirësitë e ruajtjes së vlerave humane në një shoqëri kaotike. Rrëfimi, në vetën e parë, rrjedh natyrshëm në një linjë fabulare që herë-herë ndërpritet nga episodet retrospektive, të cilat i përplotësojnë informacionet rreth personazheve, dhe nga digresionet, që e pasurojnë më tej temën e trajtuar. Ndërthurja e elementeve të tilla kompozicionale dhe funksionalizimi i tyre brenda tërësisë e shton dinamikën e rrëfimit, krahas paraqitjes së botës së brendshme të kryepresonazhit, dilemave, pandehmave dhe filozofisë jetësore të tij. Në këtë mënyrë, krijohet një ekuilibër mes kompozicionit dhe konfliktit, i cili gjithnjë paraqitet nga perspektiva e protagonistit, dhe ashtu i thjeshtë e pa dramacitet, jep mundësinë e shpalosjes së karaktereve të ndryshme njerëzore që ndërveprojnë mes tyre. Në përgjithësi, ky ndërveprim përshkohet nga një tendosje emocionale e fuqishme, intensiteti i së cilës ndryshon varësisht nga situatat e krijuara.
Edhe pse në qendër të konfliktit shfaqet dinamika e ngjarjeve brenda një kompanie bankare, që në të vërtetë është dinamika e tërë sistemit shtetëror në miniaturë, autori gjen mjete që tablonë e realitetit ta jep në përmasa më të gjera. Ai ngërthen fate, përvoja e përjetime të shumta që rezultojnë nga të jetuarit në një shoqëri kaotike, ku çdo gjë ka vlerë më të madhe se jeta e njeriut. E të jetuarit në një shoqëri të tillë, ku liria e veprimit bëhet peng i hipokritëve dhe mediokërve, doemos sjell ndjeshmërinë e poshtërimit dhe të qenit skllav në një botë moderne, në një botë ku heronjtë vdesin më shpejt se sa fama e tyre që përmblidhet në pak rreshta letër. Nga shoqëria e stërngarkuar me probleme, objektivi i shkrimtarit fokusohet më tej te familja, si qelizë e shoqërisë, që vuan qoftë nga bartja e frustrimeve nga mjedisi i jashtëm, apo nga mangësitë në ndërtimin e marrëdhënieve ndërpersonale.
Personazhi kryesor i romanit, është një intelektual që në pamundësi për të ndryshuar realitetin, tërë potencialin e vet duhet ta orientojë në mbrojtjen e integritetit, parimeve dhe vlerave të veta personale. Jo rastësisht, autori nuk i vë emër kryepersonazhit, sepse ai është vetëm njëri nga shumë intelektualët shqiptarë të kohës sonë, të cilëve, deshën apo jo, u duhet të jenë dëshmitarë të devijimeve dhe keqpërdorimeve që bëhen në emër të pushtetit. Për këtë gjendje është i vetëdijshëm edhe vet personazhi, që në një rast shprehet: "Unë jam një i panjohur në mesin e turmës miliardëshe të 'heronjve të heshtur', një njeri i paemër prej atyre që nuk kanë rastin kurrë të lënë gjurmë në historinë e njerëzimit, por që u mjafton të jetojnë jetën pa i vënë emrin e askujt tjetër".
Çështjet me të cilat preokupohen personazhet, në dukje janë të zakonshme, të përditshme, por janë pikërisht ato që po e ngufatin tërë shoqërinë shqiptare, duke mos i lënë shteg për progres. Brenda faqeve të romanit gjejmë artistin që me punën e tij nuk arrin të sigurojë një jetë normale për vete dhe familjen, gjejmë gazetarin që i zhgënjyer nga jeta jepet pas bixhozit dhe alkoolit, gjejmë njerëz me oreks të pakufishëm për pushtet që nuk i zgjedhin mënyrat për të arritur ngritjen në pozitë, gjejmë edhe të tjerë që sakrifikojnë lidhjet familjare për përfitime sado të vogla, por gjejmë edhe njerëz që udhëhiqen nga dashuria dhe janë këmbëngulës në kërkimin e një jete më të mirë. Me një fjalë brenda romanit shfaqet aktualiteti shqiptar me të gjitha plagët dhe dhembjet e tij. Përjetimet dhe situatat nëpër të cilat kalojnë personazhet e romanit, aq sa janë të tyre, janë edhe të secilit prej nesh, prandaj te lexuesi krijohet ndjesia se gjithçka po ndodh rreth tij.




Derisa kryepersonazhi shpalosë botën e tij përmes përsiatjeve mbi jetën, botën, marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe veten, personazhet e tjera njihen përmes dialogëve dhe relacioneve që kanë me të. Secili nga këta personazhe përfaqëson një segment të jetës dhe shoqërisë, prandaj secili në mënyrën e vet merr pjesë në ndërtimin e imazhit të së sotmes. Ata i shohim tek lëvizin brenda një shtjelle destruktive, forcën e së cilës e krijon shoqëria e zvetënuar nga normat morale e njerëzore. Kjo forcë i tërheq brenda vetes dhe synon t'i çekuilibrojë, në veçanti ata që nuk duan t'u nënshtrohen ligjeve të saj. Të tilla janë pjesa dërmuese e karaktereve të këtij romani, të cilët, pavarësisht nga barra që u ka ngarkuar fati, përpiqen të ecin në drejtim të kundërt me rrjedhën e lumit të shoqërisë, të vetëdijshëm që edhe nëse nuk mund të bëjnë asnjë hap tutje, së paku të mos e shtojnë fuqinë e asaj rrjedhe të gabuar.
Forca e brendshme e karaktereve të romanit dhe vendosmëria e tyre për të qenë kundër devijimeve të shoqërisë, shfaqet në sfondin e romanit edhe përmes muzikës, rok-ut, që glorifikohet si rebelim paqësor ndaj jetës. Rock-u del të jetë një mekanizëm mbrojtës për të neutralizuar pakënaqësinë dhe zhgënjimin që akumulohen çdo ditë e më tepër, në shpirtrat me ndjeshmëri të thellë. Ata janë të vetëdijshëm se tranzicioni nuk është kohë për shfaqje talenti, nuk është kohë për art, përkundrazi, arti dhe shpirti krijues ngulfaten në periudha të tilla. Megjithatë, njëjtësimi me gjigantët e rok-ut, u shërben atyre si një bastun, për t'u mbajtur gjatë shtegtimit nëpër erërat e stuhitë e kohës.
Krahas rok-ut, romani përshkohet edhe nga elemente të tjera simbolike si vdekja, shiu e ëndrra, që bartin kuptime më të thella kur shfaqen krahas peshës së rëndë të jetës. Përgjatë rrëfimit hasen situata ku vdekja ndjehet, por nuk shkakton ankth; pritet, si rrugëtim i pashmangshëm; ftohet, si zgjidhje e vetme e mbetur, apo mendohet, si akt që përmbledh edhe bilancin jetësor. Thuhet se vdekja dhemb më shumë kur jeta nuk jetohet, por personazhet e romanit, të lodhur nga përjetimet, sprovat dhe dhembjet e jetës nuk i frikësohen asaj. Përkundrazi, ajo duket e vetmja pikë drite në fund të tunelit. Ndërsa shiu që përshkon romanin fund e krye, fuqizon atmosferën e trishtë dhe monotone të kohës, ku njerëzit në vend se të jetojnë, duhet të mbijetojnë. Përpjekjet e tyre për mbijetesë shtresohen në sferat e thella të ndërdijes, ku gërshetohen me dëshirat e shtypura dhe sajojnë ëndrrat përplot makthe, makthe këto, që në fakt janë shëmbëllim i jetës së tyre.
Romani "Në Tiranë bie shi" është një pasqyrë e realitetit aktual, dëshmi e një kohe të pakohë, kronikë e një epoke ku edhe karakteret më të forta shndërrohen në qenie amorfe, ku pamundësia është tipari kryesor i 'heronjve bashkëkohorë'. Me këtë roman, Kliton Nesturi e pasuron korpusin e veprave letrare që përjetësojnë dhimbjen, sakrificat, përjetimet dhe rezistencën e intelektualëve shqiptarë gjatë periudhës së stërzgjatur të tranzicionit.

E rrallë

# Vdes qeni që njihte më shumë se 1 000 fjalë



Chaser meritonte titullin "qeni më inteligjent në botë". Ai tashmë nuk është më gjallë. Ishte i vetmi qen në planet që njihte më shumë se 1 000 fjalë të fjalorit të njerëzve, saktësisht 1 022 fjalë. Një vit më parë qeni humbi padronin e tij, psikiatrin John Pilley që banonte në Karolinën e Jugut. Ai ishte adaptuar në vitin 2004. Profesori i psikologjisë ishte i interesuar në inteligjencën e kafshëve dhe kishte stërvitur Chaser të kujtonte një numër të madh fjalësh dhe komandash. Qeni është varrosur në oborr, aty ku janë groposur edhe qentë e tjerë të familjes dhe ku është shpërndarë hiri i doktor Pilley, i cili vdiq në moshën 89 vjeç.

FOTO E DITES




Një grua shëtit përtej një deponie mbeturinash në Haiti. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Qyteti suedez kërkon licencë nga lypësit në rrugë, përndryshe pason gjoba



Një qytet suedez është bërë i pari në vend që ka prezantuar një leje zyrtare për lypje, duke kërkuar nga kushdo që kërkon para në rrugë të paguajë rreth 23 euro për një licencë. Sipas medieve të huaja, e vlefshme për tre muaj, leja mund të merret duke plotësuar një formular në internet ose në një stacion policie dhe kërkon një ID të vlefshme. Në të kundërtën, çdokush që gjendet duke lypur para do të përballet me gjobë deri në 370 euro.

## BARSOLETA E DITËS



**Në plazh fjalosen burri dhe gruaja. Në një çast burri thotë: Falënderoju fatit që këtu është pllaka në të cilën shkruan: "E ndaluar është që të hedhen mbeturinat në det", përndryshe të kisha hedhur kaherë.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Çdo ditë në ora 15:30**

### "Spider-Man Far From Home" 3D,




Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




**Çdo ditë në ora 17:30**

### "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
**Regjia:** Jon Favreau

**Në ora 19:30 dhe 22:00**

### "HOBBS & SHAW"




Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
**Regjia:** David Leitchu




**Nga dt. 08.08.2019**

### "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Marrëdhënie e shkëlqyer me partnerin. Po toleroni ngarkesat e njëri-tjetrit në punë dhe kjo gjë ju ka afruar më tepër.



**DEMI** Edhe armiqtë në raste të veçanta kthehen në miq të mirë. Kjo thënie vlen për ju sot sepse një kundërshtar i betuar do të dalë në anën tuaj.



**BINJAKËT** Sot do të jetë një ditë e qetë dhe aspak stresuese. Çdo gjë po shkon siç e keni programuar dhe do t'ju krijojë mjaft çaste të lira gjatë ditës.



**GAFORRJA** Sot do t'ju kujtohen shumë çaste të këndshme nga fëmijëria që do të doni t'i rijetonit nën një aspekt tjetër.



**LUANI** Familja do t'ju falë më tepër dashuri nga sa duhet. Kjo do të bëjë që të ndiheni shumë të izoluar nga pjesa tjetër e ambientit shoqëror.



**VIRGJËRESHA** Sot po bashkëbisedoni me njerëz që shumë shpejt do të jenë miqtë tuaj më të mirë. Njohjet e reja ju sjellin shumë surpriza.



**PESHORJA** Kujtimet do të jenë kurthi juaj në këtë ditë. Do të keqinterpretoni disa situata vetëm për shkak të kujtimeve të trishtuara.



**AKREPI** Sot do të keni debate të ashpra me një koleg pune. Nuk do të doni ta lini gjithçka vetëm në këtë zënkë, por do të krijoni situatë stresuese.



**SHIGJETARI** Karakteri juaj gazmor dhe plot ngjyra nuk shkon fare me këtë ditë që paraqitet shumë e qetë. Ndonjëherë edhe pak tonalitet neutral ju bën shumë mirë.



**BRICJAPI** Ambicia është pjesë e karakterit tuaj dhe ju e shfaqni pa shumë problem. Në shumë raste është një gjë mjaft e mirë.



**UJORI** Ju pëlqen ambienti në të cilin punoni dhe pavarësisht stresit, ju e bëni me qejf punën tuaj. Gjithmonë të pavarur në mendime, sot do të shkëlqeni.



**PESHQIT** Edhe pse sot do të keni shumë punë, do të jeni të qetë dhe do të mirorganizoni gjithçka që ju del papritur.

# Reperi shqiptar që i ka vënë 'flakën' muzikës greke



Media greke 'Greek Reporter' ka publikuar një artikull për reperin me origjinë shqiptare i cili është pjesë e grupit të shqiptarëve që kanë lindur apo kanë shkuar të vegjël në Greqi dhe tani po dominojnë skenat e vendit fqinj. Përveç Sin Boy, të njëjtin sukses po shijojnë Eleni Foureira apo Toquel. Për t'u rikthyer te Sin Boy, kjo media shkruan se reperi "përçmohet" nga shumë vetë në Greqi, por ata që e duan janë më të shumtë. "Sin Boy është një emër i madh në muzikën greke aktualisht, sidomos tek të rinjtë. Repi i tij hibrid i quajtur 'trap' karakterizohet nga një vështirësi e të kuptuarit, e kënduara me përtacëri për shkak të përdorimit të autotune, që gjithsesi është në modë", shkruhet për reperin shqiptar.



# Zbulohen planet e Kylie Jennerit për ditëlindjen e 22-të

Kylie Jenner është duke u përgatitur të niset për në Itali për ta festuar ditëlindjen e saj të 22-të. Ajo do të niset me avion privat me miqtë e saj më të ngushtë dhe anëtarët e familjes. Kylie do ta festojë ditëlindjen në një jaht privat, i cili raportohet se vlen 250 milionë dollarë, raporton "TMZ". Jahti përmban një staf prej 29 personash dhe kushton 1.2 milion dollarë në javë me qira.

# Ja se kujt ia a tribuon famën Leonardo DiCaprio



Leonardo DiCaprio është një nga yjet më të paguar në Hollywood. Ai ka luajtur me dhjetëra filma gjatë tri dekadave të fundit, duke arritur një vlerësim kritik në pothuajse secilën prej tyre, është nominuar për çmime të shumta, madje ka fituar një çmim akademie. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për suksesin e tij, 44-vjeçari është mjaft i përulur. Në një intervistë të re aktori ia atribuon karrierën e tij të shkëlqyeshme fatit. Kur u pyet nga "Mirror" se si është të jesh i famshëm, Leo dha një përgjigje të sinqertë. "Nuk e di. Unë u rrita në këtë industri. Shumë miq të mi janë aktorë".

# Albumi i ri i Post Malone del në shtator



Post Malone ka dhënë lajme të mira. Artisti 24-vjeçar ka njoftuar se albumi i tij i ri del muajin tjetër. "Albumi im i tretë do të dalë në shtator. Unë mendoj se ju do ta pëlqeni shumë, shumë, shumë", ka njoftuar Malone. Së fundmi, ai ka publikuar këngën me titull "Circles", që është pjesë e albumit të ardhshëm.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Nënshkruhet kontrata e parë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sponsorizim

Ligji për Sponsorizim ka filluar t'i sjellë shkëndijat e para, pasi është nënshkruar kontrata e parë zyrtare. Në fakt, kompania e avancuar e teknologjisë, "Gjirafa", ka nënshkruar kontratë sponsorizimi me Komitetin Olimpik të Kosovës. Kryetari i KOK-ut e vlerësoi këtë si një lajm shumë të mirë për faktin se tash është hapur rruga për marrëveshje të tjera në mes të bizneseve dhe organizatave sportive




"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 GUSHT - Kompania e avancuar e teknologjisë, "Gjirafa", i është bashkuar planit strategjik të marketingut të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). KOK-u dhe "Gjirafa" kanë nënshkruar të mërkurën kontratën e sponsorizimit, e cila njëherësh është e para që prej hyrjes në fuqi të Ligjit të Sponsorizimit në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë. Kontrata është nënshkruar nga kryetari i KOK-ut, Besim Hasani dhe drejtori i përgjithshëm i platformës "Gjirafa", Mërgim Cahani.
Kryetari i KOK-ut e vlerësoi këtë si një lajm shumë të mirë për faktin se tash është hapur rruga për marrëveshje të tjera mes bizneseve dhe organizatave sportive. "Kjo është marrëveshja e parë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sponsorizime, për çka besoj se do të jetë një lajm i mirë, një hap i parë për ta hapur rrugën edhe për marrëveshje të tjera jo vetëm që do të lidhen midis KOK-ut dhe etniteteve të tjera, por edhe midis biznesit dhe organizatave të tjera sportive, që janë federatat, klubet, por edhe sportistët", ka thënë Hasani. "E dyta e veçantë ndërlidhet pikërisht më 7 gusht 2016, ku tre vjet më parë e tronditëm botën me një lajm të jashtëzakonshëm, me një arritje të përmasave botërore, ku në shtetin që nuk na njeh, Brazilin, Majlinda Kelmendi rrëmbeu medaljen e artë dhe e renditi Kosovën në mesin e 100 shteteve me medalje të artë", ka shtuar Hasani.
Nga ana e tij, drejtori i përgjithshëm i "Gjirafës", Mërgim Cahani, shprehu kënaqësinë që kompania që drejton do të jetë partner i Komitetit Olimpik të Kosovës. "Jemi mbledhur për një arsye shumë të rëndësishme, pasi jemi duke krijuar partneritet me shërbimet e veta dhe me Komitetin Olimpik të Kosovës. Ne do të donim të inspiroheshim nga KOK-u dhe nga arritjet e sportistëve tanë në mbarë botën. Kjo për ne e bën shumë të rëndësishme nënshkrimin e kësaj kontrate dhe bashkëpunimi ynë do t'i shtojë vlerat e të dyja palëve", ka deklaruar Cahani.
Kontrata është njëvjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për vitet e tjera. "Gjirafa" iu bashkua partnerëve të KOK-ut si: "Iute Credit Kosova", "Hotel Sirius", "Toyota Kosova" dhe "KosovaPress", ndërsa KOK në javët e ardhshme pritet të zyrtarizojë edhe marrëveshje të tjera të sponsorizimit.

## SHKURT

### Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës, prioritet i FFK-së

Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës në futboll është ndër prioritetet kryesore të kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe Komitetit Ekzekutiv. "Në këtë drejtim presidenti Agim Ademi dhe anëtari i KE të FFK-së, Mirsad Çollaku, janë takuar me ekspertin e fushave të futbollit, i cili është i angazhuar në tërë regjionin për prodhimin dhe mirëmbajtjen e fushave të futbollit sipas rekomandimeve të UEFA-s. Me këtë rast ata u pajtuan për bashkëpunim rreth krijimit të fushave të reja, për renovimin e fushave ekzistuese si dhe për mirëmbajtjen e tyre, me theks të veçantë për mirëmbajtjen e fushës së stadiumit 'Fadil Vokrri' në Prishtinë", thuhet në njoftimin e lëshuar nga FFK-ja.

### Monaco, 36 milionë euro për Shaqirin

Skuadra nga Liga 1, Monaco, është e interesuar për transferimin e shqiptarit të Liverpoolit, Xherdan Shaqiri. E përditshmja zvicerane "Blick" raporton se Shaqiri mund të largohet befasisht nga Liverpooli pak orë para mbylljes së afatit kalimtar. Në fakt, Monaco është shfaqur me një ofertë të kënaqshme prej 36 milionë eurosh për përfaqësuesin zviceran. Largimi i Shaqirit nga "Reds" mund të vijë si pasojë e minutave jo të mjaftueshëm në edicionin e kaluar.

### Elliott Cole vazhdon me KB Ponte Prizreni

Një ndër basketbollistët më të mirë të KB Ponte Prizreni, Elliott Cole, ka rinovuar kontratën edhe për një sezon me drejtuesit e klubit. "Me konfirmimin e Cole skuadra deri tani ka shtuar në skuadër tre amerikanë Cole, Canada, Sanders, ndërsa në ditët në vazhdim skuadra do ta prezantojë edhe përforcimin e 4 të huaj", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Prizreni. Ponte Prizreni edhe si vjet do të jetë arrë e fortë në Superligën e Kosovës në basketboll.

### Krasniqi nënshkruan marrëveshje dyvjeçare me Ballkanin

Ballkani nga Suhareka e ka konfirmuar arritjen e marrëveshjes dyvjeçare me futbollistin Ermal Krasniqi. "Ermal Krasniqi është futbollisti më ri i FC Ballkanit. Klubi ka arritur marrëveshjen me futbollistin për dy vjetët e ardhshëm. Krasniqi është 21-vjeçar dhe me një të ardhme shumë të ndritur në fazën e sulmit. Presim nga futbollisti të jetë një ndër shtyllat kyçe si në fazën ofensive, po ashtu edhe në atë defensive", thuhet në njoftimin e FC Ballkani.
Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi ka transferuar edhe Artur Maganin, Edmond Turkun, Kushtrim Gashin, Arbër Hoxhën, Durim Gashin, Flamur Gashin, Albin Berishën, Albin Kaprën, Egzon Sinanin dhe Bleron Sekiraqën.

# Demireli: Kosova e meriton një vend special në FIBA

PRISHTINË, 7 GUSHT - Presidenti i FIBA Evropës, Turgay Demirel, po qëndron në Kosovë. Ai të mërkurën është takuar me kryetarin e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahun dhe sekretaren e përgjithshme, Elvira Dushku. Zyrtarët e FBK-së e kanë njoftuar presidentin e FIBA Evropës për rrjedhën e Kampionatit Evropian, Divizioni B, për femra U20, që po mbahet në Prishtinë. Kjo është hera e parë që një evropian i Divizionit B po mbahet në Kosovë dhe deri më tani organizimi ka shkuar për mrekulli. "Demirel është shprehur i kënaqur për mbarëvajtjen e kampionatit dhe punën që po bën Federata e Basketbollit në organizimin e këtij evropiani shumë të rëndësishëm. Presidenti i FIBA Evropës edhe një herë është shprehur se do ta ndihmojë basketbollin e Kosovës. Ai theksoi se basketbolli i Kosovës ka bërë hapa të mëdha dhe meriton një vend special edhe në FIBA", thuhet në njoftimin e FBK-së.
Demirel të mërkurën përcolli nga afër dy ndeshjet e Evropianit U20, Irlanda - Izraeli dhe Rumania - Finlanda. Ndërsa në mbrëmje ishte i pranishëm në përballjen në mes të Kosovës dhe Britanisë së Madhe në parakualifikimet e "Eurobasket 2021".



## Lladrovci: Sporti ofron njerëzit, Mali i Zi është krah i Kosovës



DRENAS, 7 GUSHT - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, e ka përgëzuar Dejan Vukiçeviqin për emërimin si trajner i ri i KF Feronikeli. Ndryshe nga disa tifozë që e kanë kritikuar emërimin e Vukiçeviqit në krye të shtabit teknik të Feronikelit, Lladrovci ka rikujtuar se Mali i Zi e ka njohur pavarësinë e Kosovës. "Ferronikeli bëhet me trajner të ri. Përgëzime për trajnerin Dejan Vukiçeviq, i cili ka një karrierë të pasur si futbollist dhe trajner. Sporti i ka afruar njerëzit, popujt, shtetet dhe kombet, nuk i ndan. E falënderoj ish-trajnerin Zekirija Ramadanin për krejt çfarë ka bërë që Ferronikeli të arrijë deri këtu. Mali i Zi është krah vendit tonë, duke e njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës si dhe përkrahëse e integrimeve në organizatat ndërkombëtare të vendit tonë. Suksese Ferronikeli, urime trajner, urime drejtor Naser Rama, urime tifozë e futbolldashës! Pas promovimit të trajnerit të ri, vendosja e luleve pranë varrit të Fadil Vokrrit është nderim për futbollistin dhe futbolldashësit në kohët e vështira dhe të arriturat e futbollit të Republikës së Kosovës", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".

# Ademi kërkon përshpejtimin e procedurave për pajisjen e futbollistëve me pasaporta



PRISHTINË, 7 GUSHT - Pas përmbylljes së procesit të marrjes së nënshtetësisë dhe pasaportës së Kosovës nga ana e futbollistit Florent Muslija, i cili iu bashkua ekipit të sukseseve, kryetari Agim Ademi dhe Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, duke i parë vështirësitë procedurale të pajisjes me pasaportë të futbollistëve kanë kërkuar nga institucionet shtetërore kompetente - Presidenca, që ta zgjedhin rrugën dhe kohën më të shpejtë të mundshme për të dekretuar dhe për të pajisur me pasaportë sportistët në përgjithësi, sepse procedura e tanishme dhe kërkesa e dokumentacioneve të shumta bënë që sportistët të kenë probleme të natyrave të ndryshme, sidomos në shtetet evropiane ku ata jetojnë e veprojnë. "Kërkojmë që për sportistët tanë të përdoret procedurë e veçantë, e cila do ta mundësonte dekretimin dhe pajisjen e tyre me nënshtetësi dhe pasaportë në afatin më të shpejtë të mundshëm. Ky veprim do ta mundësonte kompletimin e ekipeve tona sportive dhe do ta realizonte më shpejt dëshirën e madhe të bashkatdhetarëve tanë që nëpërmjet sportit ta japin kontributin për atdheun e tyre - Kosovën. Besojmë se kjo kërkesë e jona do të hasë në mirëkuptimin e plotë të institucioneve shtetërore dhe në të ardhmen sportistët tanë nuk do të hasin telashe të tilla procedurale për t'u pajisur me pasaportë të Kosovës, ngaqë edhe koha e tyre për t'u marrë me çështje të tilla është e limituar, duke pasur parasysh faktin se janë pjesë të klubeve të mëdha evropiane", thuhet në njoftimin e FFK-së.

# Skënderbeu rikthen Dajën




KORÇË, 7 GUSHT - Ilir Daja është trajneri i ri i Skënderbeut ose, më saktësisht, kthehet një vit pasi kishte lënë drejtimin e korçarëve për të shkuar te Flamurtari. Trajneri me të cilin korçarët përjetuan sezonin më të suksesshëm në historinë e futbollit shqiptar, me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme edhe në grupet e Ligës së Evropës, ka rënë dakord me drejtuesit dhe të mërkurën ka qenë i pranishëm në zyrat e klubit. Daja do të ketë një detyrë më të vështirë këtë radhë, pasi do t'i duhet të ndërtojë thuajse nga e para ekipin nga i cili janë larguar pjesa më e madhe e atyre emrave që shkruan historinë e futbollit shqiptar. Megjithatë, klubi i ka garantuar se do të ketë në dispozicion gjithsesi një grup cilësor, me të cilin si objektiv do të jetë arritja e kualifikimit në kupat e Evropës. Gjithçka për të hequr edhe një vit nga dënimi i dhënë nga UEFA, ndërsa pritet edhe vendimi që del nga Gjykata Federale në Zvicër ku është bërë animimi për vendimin në KAS. Marrëveshja është njëvjeçare. Vazhdimësia e saj do të jetë në varësi të asaj që do të dalë nga zyrat e gjykatës në Zvicër.

## SHKURT

### Ajeti, afër West Hamit

Sulmuesi shqiptar i Baselit, Albian Ajeti, është afër transferimit në Premierë Ligë. 22-vjeçari në dy sezonet e fundit ka qenë golashënuesi më i mirë në Superligën e Zvicrës, kurse në këtë afat kalimtar pritet t'i bashkohet West Ham Unitedit. "Blick" raporton se West Hami do të paguajë deri në 12 milionë franga për Ajetin. Largimi i Ajetit në drejtim të West Ham Unitedit do t'i hapë mundësi edhe më shumë Kemal Ademit për paraqitje të Baselit.

### Pensionohet Forlani

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Uruguait, Diego Forlan, ka konfirmuar pensionimin e tij nga futbolli profesionist. 40-vjeçari për herë të fundit ka luajtur për klubin nga Hong Kongu, Kitchee, derisa ka djersitur edhe fanellat e shumë klubeve evropiane si Interit, Villarrealit, Atletico Madridit dhe Manchester United. "Nuk ka qenë e lehtë, nuk doja që ky moment të vinte, por unë e dija se një gjë e tillë do të ndodhte. Kam vendosur të mos luaj më futboll si profesionist", ka thënë Forlan, i cili e nisi karrierën e tij si profesionist me Independiente në Argjentinë.

### Unitedi synon dy yjet e Tottenhamit

Manchester Unitedi kërkon të tjera përforcime përpara përfundimit të afatit kalimtar të verës duke targetuar dy futbollistët e Tottenham Hotspurit. Eriksen dhe Llorente janë dy emrat që 'Djajtë e Kuq' do të synojnë t'i transferojnë në "Old Trafford". Erikseni nuk është në planet e trajnerit Mauricio Pochettino që kur ai i bëri me dije se kërkon sfida të tjera dhe tek Unitedi ai shihet si zëvendësues ideal për Paul Pogban. Ndërsa Llorente shikohet si një alternativë mjaft efikase në sulm. 34-vjeçari bëri një sezon të mirë vitin e kaluar me Tottenhamin dhe gjasat janë të mëdha që ai te transferohet në United si lojtar i lirë.

### Neueri synon Ligën e Kampionëve

Kapiteni i Bayern Munchenit, Manuel Neuer, e pranon se edicioni i fundit nuk ishte i mirë për skuadrën gjermane në Ligën e Kampionëve, por beson se në edicionin e ri Bayerni do ta thotë fjalën kryesore në garën më të fortë. "Pas eliminimit të shpejtë në Ligën e Kampionëve vitin e shkuar, duam të kthehemi përsëri në statusin e favoritit. Sezoni i shkuar ishte zhgënjyes për mua, nuk mund ta fsheh këtë. Këtë vit do të synojmë të kthehemi aty ku ishim në 2013-n. Dua ta fitoj Ligën e Kampionëve edhe një herë. Mendoj se drejtuesit po bëjnë punën e duhur që të jemi përsëri konkurrues në Evropë dhe ta fitojmë përsëri trofeun, ky është edhe qëllimi im", ka thënë Neueri.

### Welbeck në Watford

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Anglisë, Danny Welbeck, është futbollist i ri i skuadrës së Watfordit. "Goal" raporton se sulmuesi i bashkohet Watfordit si transferim i lirë, pasi i ka përfunduar kontrata me Arsenalin. 28-vjeçari ka luajtur edhe për Prestonin, Sunderlandin dhe Manchester Unitedin.

### Milani ëndërron transferimin e Modriqit

Drejtuesit e Milanit po punojnë për një goditje të madhe në këtë merkato dhe ajo mund të jetë Luka Modriq. Sipas asaj që shkruan "Sport Mediaset", Zvonimir Boban po punon prej kohësh për të sjellë bashkëkombësin e tij në "San Siro". Gjithsesi ky operacion është shumë i vështirë, pavarësisht se e vetmja skuadër ku 33-vjeçari dëshiron ta vazhdojë karrierën, pas Real Madridit, janë pikërisht kuqezinjtë. Një problem është edhe paga e lartë e lojtarit, por kuqezinjtë e kanë menduar zgjidhjen, pasi do t'i ofrojnë atij një pagë prej 7.5 milionë eurosh në sezon plus bonuset, për dy vjetët e ardhshëm. Florentino Perez kërkon të paktën 25 milionë euro për mesfushorin dhe mund të arrihet marrëveshja për shkak të marrëdhënieve të mira mes dy palëve.

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË KIESA

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria–Vlada-Government***

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese të kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e produkteve ushqimore dhe pijeve "ANUGA" në Cologne (Këlln) të Gjermanisë më 05–09 tetor 2019**

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e dhjetë (10) subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 20.08.2019 dhe vetëm aplikacionet e plotësuara tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

1. Për të aplikuar duhet dorëzuar:
   1.1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
   1.2. Dokumentet e kërkuara.

2. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
   2.1. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
   2.2. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
   2.3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
   2.4. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë).
   2.5. Deklaratën nën betim;
   2.6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2018 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
   2.7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

1. Dhjetë (10) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kritereve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
   1.1. Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt, tre (3) pikë për dy produkte, pesë (5) pikë për tri (3) produkte, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
   1.2. Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Angleze pesë (5) pikë, gjuha Gjermane katër (4) pikë dhe gjuhët tjera një (1) pikë;
   1.3. Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Angleze katër (4) pikë, në gjuhën Gjermane katër (4) pikë dhe dy (2) pikë në gjuhë tjera evropiane;
   1.4. Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë viteve 2017 dhe 2018, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së pesë (5) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) tri (3) pikë dhe tregjet e tjera dy (2) pikë;
   1.5. Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesë (5) pikë kumulative: HACCP dy (2) pikë, ISO 22000 dy (2) pikë dhe certifikim tjetër relevant një (1) pikë;
   1.6. Paraqitja e subjektit aplikues në panaire tri (3) vitet e fundit, maksimum pesë (5) pikë: një panair një (1) pikë, dy (2) panaire dy (2) pikë, tri (3) panaire tri (3) pikë, katër (4) panaire katër (4) pikë dhe pesë (5) e më shumë panaire pesë (5) pikë; dhe
   1.7. Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2018, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 15.08.2019, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 20.08.2019 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rruga Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MTI apo të shkarkohen nga faqet e internetit mti.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën export.kiesa@rks-gov.net.

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË KIESA

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria–Vlada-Government***

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

U cilju promovisanja proizvođaćkih kompanija na Kosovu u pronalaženju stranih tržišta za izvoz, Ministarstvo Trgovine i Industrije preko Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima na Kosovu (KIESA) objavljuje:

**Javni poziv za apliciranje za učešće na državnom štandu Kosova na sajmu prehrambenih proizvoda "ANUGA 2019" Cologne u Nemačkoj 05 - 09 october 2019**

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstva Trgovine i Industrije, odnosno Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima KIESA koja pokriva troškove izložbenog prostora, izgradnju štanda, registraciju deset (10) učesnika, troškove električne energije, svakodnevno čišćenje, itd., dok će troškovi putovanja, smeštaja, hrane, isporuke promotivnog materijala itd. subjekata koji učestvuju, biti preduzeti od samih učesnika.

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja poslata do 20.08.2019 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

1. Da biste aplicirali treba dostaviti:
   1.1. Aplikaciju popunjenu osnovnim podacima subjekta koji aplicira; i
   1.2. Potrebne dokumente.

2. 2. Potrebni dokumenti za apliciranje:
   2.1. Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
   2.2. Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
   2.3. Kopija lične karte ovlašćenog lica aplikanta;
   2.4. Uverenje Suda da ovlašćeno lice subjekta nije pod istragom (potreban je original, ne stariji od 30 dana);
   2.5. Izjava pod zakletvom;
   2.6. Potvrda godišnjeg prometa aplikanta za fiskalnu godinu 2018 od strane Poreske Administracije Kosova; i
   2.7. Poresko uverenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

